



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 tetor 2012
Nr. ref.: RK313/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

Rasti Nr. KI74/11

Parashtrues

Rasim Nikoqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së dështimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë për të
nxjerrë aktgjykim në një padi**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Rasim Nikoqi nga Gegehysenaj, Republika e Shqipërisë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston refuzimin e shqyrtimit të një padie nga Gjykata e Qarkut në Pejë.

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është refuzimin shqyrtimit të e padisë së parashtruesit nga Gjykata e Qarkut në Pejë. Parashtruesi pretendon që është diskriminuar, për shkak se i njëjti është shtetas i Shqipërisë, pasi që Gjykata e Qarkut në Pejë, ka dështuar të nxjerrë një vendim lidhur me padinë e ushtruar nga ai. Fillimisht padi të ushtruar në Gjykatën Komunale në Gjakovë në vitin 2003.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 10 maj 2011.
6. Më 27 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Komunale në Gjakovë të dërgonte informata përkitazi me këtë kërkesë. Të njëjtën datë, Gjykata kërkoi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të ofronte përgjigje në këtë kërkesë.
7. Këshilli Gjyqësor i Kosovës iu përgjigj Gjykatës, nëpërmjet letrës së 29 korrikut 2011, duke theksuar se gjyqtari i çështjes në fjalë ishte nën hetime, pasi lënda nuk ishte caktuar për pesë vjet.
8. Gjykata Komunale në Gjakovë iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese më 1 gusht 2011 dhe, më pas, më 23 shkurt 2012. Gjykata Komunale iu drejtua Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar informata të tjera përkitazi me këtë çështje nga Gjykata e Qarkut në Pejë.
9. Më 17 gusht 2011, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari e caktoi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Prof.dr. Enver Hasani (anëtar) dhe Iliriana Islami (anëtare).
10. Më 19 shtator 2012, Kryetari, me vendimin KSH. 74/11, caktoi anëtarët e Kolegjit të ri shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: Altay Suroy (kryesues) i cili e zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, e cila e përfundoi mandatin si gjyqtare në Gjykatë më 26 qershor 2012, Almiro Rodrigues (anëtar) dhe Prof. dr. Enver Hasani (anëtar).
11. Më 20 shtator 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Faktet e rastit siç pretendohen nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi

12. Më 26 prill 2002, parashtruesi u dënua nga Gjykata Komunale në Gjakovë me 30 ditë paraburgim, pas gjykimit nën akuzat për "tregti të paligjshme", sipas nenit 116.1 të KPK-së. U sekuestruan mallra (435 arka me birrë) me vlerë 5.972,50 euro. Më 16 maj

2002, parashtruesi u shpall fajtor, u lirua nga paraburgimi dhe u dënua me gjashtë muaj burg – që u pezullua.

13. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Pejë dhe ajo gjykatë më pas ia ktheu rastin Gjykatës Komunale në Gjakovë, e cila më pas e rigjykoi këtë rast dhe, më 1 janar 2003, i hodhi poshtë akuzat penale, nxori një vendim për shpenzime dhe urdhëroi që mallrat t'i ktheheshin parashtruesit.
14. Më 24 mars 2003, nëpërmjet avokatëve të tij, parashtruesi ushtroi padi civile në Gjykatën Komunale në Gjakovë për shpenzime dhe për kompensim. Sipas dokumenteve të dorëzuara nga parashtruesi, gjykimi për padinë e parë ishte caktuar për 17 dhjetor 2010 dhe, më pas, ai u shty deri më 24 mars 2011, me ç'rast, gjyqtari i caktuar në këtë çështje kërkoi të përjashtohej nga ky rast, pasi ishte gjyqtar në rastin e parë penal.

Shkeljet e pretenduara të Kushtetutës

15. Parashtruesi pohon, në përgjithësi, që ka pasur shkelje të rëndë të të drejtave themelore të garantuara me nenet: 7 [Vlerat], 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut] dhe 102 [Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor] të Kushtetutës, si dhe me nenin 41 të KEDNj.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

16. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.
17. Neni 113, paragrafët 1 dhe 7, i Kushtetutës përcakton kornizën e përgjithshme juridike që kërkohet për pranueshmëri. Ai përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

18. Edhe sikur parashtruesi t'i kishte shteruar të gjitha mjetet efektive juridike në dispozicion sipas ligjeve në fuqi, Gjykata thekson se, në mënyrë që një kërkesë të trajtohet në Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi, para së gjithash, duhet t'i mbështesë me prova pretendimet e tij për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me KEDNj.
19. Përkitazi me këtë, neni 48 i Ligjit, thotë:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

20. Së fundi, rregulli 36 i Rregullores së punës, përcakton:

*“1. Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:
c) kërkesa është qartazi e bazuar.*

2. Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:
- a) kërkesa nuk arsyetohet *prima facie*, ose
 - b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose
 - c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose
 - d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”

21. Në procedurat që i kishte iniciuar në gjykatat vendëse, parashtruesi ishte i përfaqësuar nga një avokat. Megjithatë, parashtruesi fare nuk ka treguar apo ofruar prova për ta mbështetur pretendimin se vonesa rrjedh nga diskriminimi për shkak të shtetësisë së tij. Parashtruesi nuk ka bërë asnjë krahasim për të treguar se ai, si shtetas i Republikës së Shqipërisë, është trajtuar ndryshe nga personat e tjerë që paraqiten në gjykata të Republikës së Kosovës. Nga deklaratat e tij e thatë nuk mund të konkludohet që ka pasur diskriminim të tillë.
22. Parashtruesi as nuk ka treguar e as nuk ka ofruar prova që ka ndërmarrë hapa për të kërkuar nga gjykatat e rregullta që ta përshpejtonin padinë e tij (përveç ankesës në Këshillin Gjyqësor të Kosovës). Padia e parë është në pritje e sipër për vendim në gjykata të rregulla. Pala, në asnjë mënyrë nuk tregon se, në padinë e parë, i kishte ngritur çështjet e lartcekura sa i përket shkeljeve të të drejtave të tij të garantuara me ligjet dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me KEDNj.
23. Prandaj, në pajtim me nenin 117.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 47.2, 46 dhe 48 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36.2 (a, b, c dhe d) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe hedhet poshtë si e papranueshme, sepse nuk është *prima facie* e arsyetuar, apo e mbështetur me prova të mjaftueshme.
24. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 20 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 56.2 të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenet 47.2, 46 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, dhe në pajtim me rregullin 36.2 (a, b,c dhe d) të Rregullores së punës, më 20 shtator 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani